



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 350-13760/15
Kaçanik, 28. 04.2015

Në bazë të nenit 12, 17 dhe 18.1 (a) të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), të nenit 4 të Ligjit 03/L-139- Për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 28.04.2015, mori këtë:

V E N D I M
PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM
TË NGASTRAVE KADASTRALE NË Z.K. KAÇANIK PËR INTERES TË KOMUNËS

1. Me këtë Vendim, shpallen me interes të përgjithshëm- për interesa të komunës, patundshmëria e ngastrave kadastrale në Z. K-le në Kaçanik, me numrat si vijon:

- 00515-0, 00516-0, pronar Zejdije Dushkaja, e veja e Hasanit,
- 00494-9, pronar Amer Shaqir Shurdhani,
- 00494-8, me pronar Agron Shaqir Shurdhani,
- 00494-1, me pronar Jeton Shaqir Shurdhani,
- 00498-2, me pronar Andan dhe Visar Shemi Shehu, me nga ½ e ngastrës,
- 00501-1, me pronar Haki Jenuz Shurdhani,
- 00502-7, me pronar Isamedin Ali Shurdhani,
- 00507-1, me pronar Zejadin Sahit Loku,
- 00507-2, me pronar Zylfi Sahit Loku, dhe
- 00513-0, 00514-0, me pronar Salije Teneqja, e veja e Faikut.

2. Ngastrat kadastrale të cekura si në pikën 1. të këtij Vendimi, destinohen për interesat e komunës së Kaçanikut - për vazhdimin e ndërtimit-rregullimit të shtratit të lumit “Nerodimja” në Kaçanik, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të tjetërsohen dhe as t’i ndërrohet destinimi pa vendimin e Kuvendit të komunës së Kaçanikut.

3. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, sipas ligjit t’i kryej të gjitha procedurat e nevojshme të shpronësimit të patundshmërisë së përcaktuar si në pikën 1. të këtij vendimi.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i komunës dhe drejtoria për Urbanizëm, Kadasër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të MAPL si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Urbanizëm, Kadasër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
3. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim,
4. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, dhe
5. Arkivi.

